

Procesverbal

Nga seanca e V-të (pestë) e Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 15.05.2018, duke filluar në ora 10.00, me këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit, nga seanca e kaluar e Kuvendit...
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit Vjetor/2017 të kryetarit & organeve komunale, me planet e punës, për vitin 2018,
3. Njoftimi dhe miratimi i Raporti vjetor 2017 të KKSb-së me P/Veprimt, për vitin 2018.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit 3-mujor financiar/2018,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Kërkesë së z.Lulzim Rifaj për Projektin e Planit Regulativ për parcelat 1531 dhe 301/3 në Dragash,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Kërkesë së investuesit NPN "Niki-GD" në Dragash për miratimin e kushteve të ndërtimit për realizimin e projekteve të parapara..., dhe
7. Eventuale...

Seancën, me përshëndetje të pranishmëve... e hapi kryesuesi i KK-së z.Betim Merdiu, me kërkesën e deklarimit të delegatëve, nëse ka vërejtje apo plotësime të rendit të ditës, të dërguar me Ftesë...? Nëse jo, miratohet, njëzëri, rendi i ditës.

Pika e I-rë (parë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Si zakonisht, fillimisht, kemi shqyrtimin dhe miratimin e Procesverbalit nga seanca e kaluar e Kuvendit, nëse ka vërejtje apo plotësime...?

z.Samidin Xheladini- Meqenëse materiali është i gjerë, nëse është e mundur, të dy kërkesat të z.Lulzim Rifaj dhe e "NIK-GD", që janë të ngajshme, të shqyrtohen-bashkarisht, për t'u lehtësuar puna e Kuvendit?

z.Laurat Krasniqi- Kërkesat e praqitura janë të ndryshme e njera për Leje Ndërtimore, e që nuk i japim ne por DURbanizmit. Ne duhet të kemi Planin Regulativ e po t'a kishim do të jepnim leje ndërtimore e, pasi se nuk e kemi, ato duhet t'i jep DURbanizmit.

Kryesuesi- Në rregull, nëse nuk ka edhe diçka, konstatoj se miratuar Procesverbalin e seancës së kaluar.

Pika e II-të (dytë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me pikën e II-të të radhës ku kemi shqyrtimin dhe miratimin e Raportit Vjetor /2017 të kryetarit dhe organeve komunale, me planet vjetore/2018, hapim diskutimet...?

z.Samidin Xheladini- Për këto dokumente po theksoj se fjala është për një material të gjerë dhe mendoj se drejtorët e tashëm nuk kanë përgjegjësi për mospunën e ish-drejtorëve në raportet e tyre e që janë autor, kurse sa u përket planeve ato janë si ata të mëparshmit e që kërkoj planifikimi të ishte më i mirë, meqenëse jemi komuna më e varfër e planit e reja e përmbajtësore i kontribuojnë zhvillimit e që pra të nxiten e përkrahen bizneset e çështjet tjera.

z.Velid Haxhisin- Unë e kam lexuar detalisht Raportin e unë, tek Plani i Emergjencës, vërejtja ate se në cilën mënyrë do të zgjidhet çështja e rrëshqitjes së gurëve e cila përmendet në Raport, me gjasë, nga ish-drejtori? Kjo problematik pëcillet e përmendet qe 5 vite? Te investimet vërhen dallime të mëdha si psh.në Bresanë e Restelicë, që janë afërsisht të njejtja nga madhësia e ka dallime. Ne e kemi QM në Krushevë e cila kryen të njejtat shërbime si ambulanca në Restelicë eë që ka më shumë intervenime e propozoj që ekipet e QM të Krushevës të ofrojnë shërbime edhe në Restelicë, pasi se pacientët po orjentohe në Dragash, që mendoj se lidhur me këtë banorët e Restelicës janë të diskriminuar e është fol me vite se kjo çështje do të rregullohet e ende asgjë pozitive? Sa i përket Raportit,vërhet edhe ajo se në te mungon Raporti i ZLKKhtimirt e cila është pjesë e ekzekutivit e që, s'paku, të ishte i prezentuar për në Kkomunitete e që kemi marr përgjigje nga kryetari se ai Raport i saj do të prezentohet?

z.Nexhat Isufi- Në Raport, mjaft çështje janë përcjellur nga viti i mëprashëm. Por, ajo që mua më brengos është mospërfshirja e shumë çështjeve të cilat janë zhvilluar nëpër drejtorate si psh. Në Dhëndetësisë nuk përmendet se në shëndetësi punohet me vulën e Serbisë nga personi i paguar nga buxheti i Republikës së Kosovës, që lëshon udhëzime specialistike me vulën e Republikës së Serbisë-Shtëpia e Shëndetit Dragash?! Emti i tij është dr.Nihat Osmani e aty shkuan f.Ljubovishte-Komuna e Gorës?! Duhej të qëndronte në Raport se punëtori i tyre aty shkuan f.Ljubovishte-Komuna e Gorës?! Duhej të qëndronte në Raport se punëtori i ynë punon në institucionin e Republikës së Serbisë?! Po ashtu, nuk e dijmë , si dhe nuk dihet se ky dokument a është nga drejtori i mëparshëm apo nga ky tani, pasi se nuk përmendet në Raport emri i tij, që pra është dashur të përfshihet në Raport gjithçka që është punuar.

z.Samidin Xheradini- Lidhur me Raportin e Shëndetësisë dhe ofrimin e shërbimeve aty, sipas meje nuk duhet ndëshkuar punëtorët, pasi se përmes sporteleve janë bërë 5 mijë vizita para dite e pas dite asgjë. Kanë qenë 3 mijë intevencione dhe 600 në stomatologji e vetëm unë (si teknik-laborant) i kam pasur afro 1 mijë raste e që këto janë dashur të përfshihen në Raport. Ajo që desha të theksoj se kryetari duhet të ndërmer masa për funksionimin pa pengesë të internetit, pasi se kjo është pengesë për qytetatrët në nxjerrjen e dokumenteve dhe ofrimin e shërbimeve publike në tërësi.

Kryetari- Në seancën e sotme po e shqyrtojmë punën e kryetarit dhe organeve tjera komunale, si dhe planeve të punës, është normale, që të diskutohet e të jepen vërejtje e që, për raste të këtilla, mund të ketë edhe gabime, por edhe vërejtje e që mund të kemi raporte e plane jo të plota, përfshi këtu edhe ate se qenkan identike me ato të viteve paraprake. Raportet pasqyrojnë punën e shkuar,

kurse me rëndësi është koncentrimi në planet për vitin vijues, që të tejkohen dobësitë që theksohen. Me raporte është qëllimi që të arrihet ajo që është paraparë e në këtë kontekst z.Velid H. theksoi përmendi disa çështje nga DEmergjencës lidhur me rrëshqitjen e dheut dhe gurëve në Restelicë që ka pasur aktivitete të Drejtorit e që kjo mbetet obligim edhe me planin e punës së tyre, pasi se është rrezik për qytetarët. Për Retelicë kishte edhe kërkesa reth shërbimeve shëndetësore e që edhe kjo paraqet obligim për DShëndetësisë e që sugjerimet e vërjetjet do të merren parasysh për të ofruar shërbime qytetarëve jo vetëm nga QMF e Krushevës. Sa i përket Raportit e Planit të ZLKKthimit, unë për këtë kam biseduar me shefin e Zyrës dhe nuk është problem, që t'a kemi në seancë. Në diskutimin e z.Nexhast I. vërejtja ishte se disa punë po përcillen, nga viti në vit, që kjo qëndron me obliim që të kryhen, kurse sa i përket punës së mjekur me dokumentacion të Republikës së Serbisë, dihet se ne këtu punojmë me dokumentacion të Republikës së Klosovës e që duhet të punojnë të gjithë e që mjerisht, te ne, disa institucione po veprojnë ndryshe e që është theksuar shpesh-herë edhe këtu, e që si duket, kjo dukuri po i tejkalon kompetencat tona, edhe pse është portencuar në instanca më të larta. Ajo që mund të bëhet është se në Dshëndetësisë duhet të janë të kujdesshëm reth kësaj çështjeje që gjendja të zgjidhet e për të mos ardhur në kundërshtim me ligjet tona. Sa i përket Demergjencës dhe punësimit të ndonjë inspektori, do të vlerësohet rëndësia reasle për këtë.Sa i përket internetit dhe probleme nëpër zyra të vendit, po theksoj se kemi probleme me rënie të shpeshta të rrjetit që po reflektohen në dhënien e dokumentave personale qytetarëve. Unë jam angazhuar që, me zyrtarin e TI, të ofojmë zgjidhje momentale, por disa gjëra tejkalojnë mundësitë tona. Gjithsesi, të gjitha vërjtjet që u thanë do të merren parasysh nga ana e drejtorateve, që hap pas hapi, të eliminohen dobësitë, në të ardhmen.

z.Basri Gashii(zyrtar i TI)- Sa i përket internetit, dje probleme kanë pasur vetëm ZV në Brod e Bresanë e që janë furnizuar përmes postës e që po theksoj se nga muaji tjetër gjithçka do të jetë në rregull, kurse për ZV në Llopushnik ,kemi probleme.

z.Nexhat Isufi- z.kryetar, kam dëgjuar për këtë mjeri-mjek për të cilin flitet se qenka njeri i mirë dhe njpë gjë e diç se nuk jam nacionalist, por e dua shtetin tim. Dhe, nëse Qeveria e Kosovës me Miniastriinë Shëndetësisë ka punësuar dikend i cili paska 2 vule të 2 shteteve, a<tëherë ajo Qeveri e Ministri duhet të reagon e paguhet me mjetete e tatim paguesëve tonë, ne duhet këtë t'a pengojmë, duke i vu kushte se me cilën vulë do të punon?! Në të kundërtën, kështu ne po u lëm hapësisë për të vepruar kështu edhe institucionet tjera paralele e unë sot e prita reagimin e ndonjërit nga zyrtarët kompetent e unë këtë e theksova nga se e kam obligim si i zgjedhur i qytetarëve.

z.Samidin Xheladini- Qasje e mirë për zgjidhje të problemeve që e përshëndes dhe është mirë që u informuam për rastet e këtilla. Sa i përket shëndetësisë, unë si teknik do të prprozoja një plan për inihalim të mjeteve, si dhe plan për bashkëpunim me donatorët për të përfituar sa më shumë mjete për komunën tonë, nga se drejtorët i kemi të rinjë e, si të tillë, kanë obligime.

z.Selman Osmani- Ky Raport, sipas meje, është i pranueshëm. Ndoshta, disa gjëra mund t'i përris, por e gjithë kritika po përfshinë shëndetësisën dhe do të pyesësja pse gjithkuj kritika kur është në pyetje shëndetësia ndaj njerëzëve. Prandaj, unë do të kisha lutur dr.R:Jasharin apo B.Brenollin që këto që theksohen mos t'i kuptojnë si qëllimkqija, por si kritika pozitive, që raportet tjerë të janë më transparent. Një kritikë për Raportin, se unë aty nuk e vërjetja politikën e punësimit në atë Drejtorat, pasi se kemi pasur rastin të ngelim pa gjinekolog e jemi 36 fshatra? Po ashtu, në Dragash mungon pediatri i fëmijëve? Tani jemi në situatë kur një numër mjekësh duhet të shkojnë në pension e ne nuk kemi strategji reth zëvendësimit të tyre e që po del se do të ngelim pa mjek, siç kemi ngel pa gjinekolog e që kritikën tona drejtorët e shëndetësisë duhet t'i marrin, si kritika serioze. Meqenëse unë jam nga Krusheva, diçka po theksoj se atje QMF-ja nuk ekziston dhe është e shëndërruar në zyrë të një partie politike -"Vakat" e kjo paraqet marri që po ngjanë e unë këtu po paraqitem si delegat dhe i sëmur me stenda të vendosura në trup, pasi se kam pësuar 4 infrakte e sheqerinë e kam në gradën 12 e, vetëm në Krishevë, ka 56 persona me smundje diabeti e që u mungon insulina?! Nëse shihni raportet lidhur me participimet vërhet se vizitat kanë qenë 1 apo 2 pacientë e atje janë 10 të punësuar-me mjekun, stomatologun, teknikun e s'di se çka tjetër e psh.një Retelicë, me 8 mijë banorë, shërbehet vetëm nga një mjek?! Ekziston një automjet i ndihmës së shpejt për transport në Spitalin Rajonal e unë kisha infrakt e po u dashka të pyetet dr.Nazif K. e kjo është marri për të gjithë ne dhe ndaj qytetarëve, pavarësisht se cilit komunitet i takojnë. Çështje tjetër të cilën do të theksoja e po e përsërisë është ajo që kërkova lidhur me sigurimin e paisjeve speciale medicinla në shumë prej 117 mijë eurove e ne këtu në Dragash nuk e kemi insulinën e domosdoshme. Lidhur me politikën e punësimit të merren parasysh struktura kualifikuese e punëtorëve e jo të punon dikush me 4 klasë të shkollimit në punët administrative për çështje sociale, e sipas të cilave, vendos një punëtor i tillë. Edhe disa pyetje për DUrbanizmit se çka u bë me atë ujsjellës famoz qendror, me trafo-stacionet në Brod e që kryetari, Shaban duhet t'i fton drejtorët për punë të përbashkët e që ne këtu të njoftohemi me punët e bëra. Kam edhe pyetje për Darsimit, e s'di nëse është koordinatori i arsimit, që të njoftohemi se si zhvillohet mësimi nëpër shkolla, siç kemi rastinin në shkollën "Svetlost" në Krushevë që ka nevojë të kontrollohet puna dhe diplomat në atë shkollë?! Po ashtu, kisha kërkuar që të lirohet Qendra e Komuniteteve, e shëndërruar në zyrë të parisë politike apo për OJQ-të ku edhe z.B.Brenolli ka qenë pjestarë i tyre, e qytetatrët aty nuk kanë qasje, nëse nuk je anëtar i "Vakatit" e mardhëniet ndërnyerësore janë në pikën kritike atje, që nevojitet të dihet destinimi i Qendrës së tillë?!

z.Sefidin Mejzini- Meqenëse ky është Raport i kryetarit dhe organeve komunale, kemi brenga të caktuara. Dje-te Kryetari kanë qenë dy përfaqësues të f.Kosavë e fjala është për 5 rrugë për kubëzim për të cilat keni dhënë premtime para zgjedhjeve, apo po përdorni fjalën popullore reth kalimit të lumit me kal...?! Këtu është fjala për buxhetin e vitit 2017 në shumë prej 30 mijë eurove e që ato rrugë duhet të përfundojnë e në tërësi janë 300 m. Rrugë e mos të shfrytëzohen "standardet e dyfishta" ndaj familjeve e që kjo nuk është "fer"?! E tani jemi në vitin 2018 kur duhet të miratojmë buxhetin e vitit të ardhshëm e projektet e paraparake duhet të përfundojnë. Ajo firmë dhe personi i cili i ka marr punët për kryerje tash më është paguar për gjysmën e punimeve e punët janë siç janë e tani kanë

kaluar zgjedhjet e janë harruar premtimet e kjo nuk është mirë për politikajt. Po ashtu, nga Kryetari është nënshkruar Vendimi për moskubëzimin e rrugëve private e të ne kemi raste të tillë. Kjo nuk është lutje, por po ju njoftoj për situatën momentale, pasi se kryesi i punimeve ka vendosur në rrugë vetëm pak zhavor e i ka lënë punët në gjysmë?!

z.Velid Haxhisin- Unë u lajmërova për replikë në diskutimin e z.Selman O. edhe pse ishte edhe konstruktive, por kishte edhe emocione dhe theksoj se asnjë institucion në komunën tonë nuk është i partive politike e ju e përmendët këtu "Vakatin" i cili, në asnjë mënyrë, nuk ka penguar qesjen në një institucion-pavarësisht se a është arsimore apo shëndetësore e ajo se ju po ndiheni të papërshtatshëm për t'u qasur në disa institucione e në disa situata, ky është problemi yt? Pra, unë dëshiroj të distancoheni nga ajo se asnjë institucion komunal nuk i takon partive politike. Nëse veprojmë kështu, edhe z.Nexhat I. kishte të drejtë kur përmendi rastin e institucioneve paralele në shëndetësi dhe ju lutem t'i lëmë këto gjëra e të merremi me çështje me rëndësi për popullatën.

z.Arjeta Skeraj- Unë do të ndërlihem në Raportin e DSHëndetësisë dhe s'di se i cilit drejtor është-i të kaluarit apo i të tashmit? Do të dëshiroja të theksoj diçka reth mungesës së gjinekologut-es e cila është çështje brengosëse e kjo është si pasojë e rënies së plleshmerisë e, nëse zvogëlohet numri i pacientëve janë të rrezikuara edhe punët për punëtorët shëndetësor. Një pyetje që do t'i parashtroja DSHëndetësisë është se a i nënshkruajnë punëtorët tuaj Listat e pagave, pasi se kam dëgjuar se, disa punëtorë, nuk e dijnë se sa e kanë pagën dhe koeficientin, si dhe a paguajnë sindikatin e pagesa tjera? E treta-në veturën e ndihmës së shpejt nga Dragashi sillen pacientët për Spitalin Rajonal të Prizrenit-pa përcjelljen e teknikut, por vetëm me vozitësin, dhe a është fjala për mungesë të kadrin e çka mund të ngjanë gjatë 36 km-ve, se çka do të bënte vozitësi nëse ngan defekti dhe nevoja e ndihmës ndaj pacientit?! Te PPunës së DARSimit, nuk përmendet funksionimi i Qerdhes së Fëmijëve apo vendosja e saj në funksion dhe se a pritej hapja e saj, për të funksionuar për herë të parë? Po ashtu, në Rrenc ka mundësi të hapet paralelja e arsimit parashkollor, nga se janë 14 nxënës parashkollor, që është numër i mjaftueshëm për hapjen e saj?

z.Vehbi Nazifi- Edhe pse raportet gjithnjë kanë mundësi për plotësime e kritika, për mua ky Raport është real, pasi se nuk ka tejkalime të gjërave. Shumica e parafolësëve u koncentua në kritika të DSHëndetësisë, që është edhe logjike, pasi se ky Drejtorat e shërbimet e tij janë në kontakte direkte me qytetarët e nga ata vijnë më së shumti ankesa, kërkesa e kritika e që mendoj se nevoiten reforma për t'u përshtatur në trendet e reja të kohës përmes riorganizimit të shërbimeve, si në QKMF, po ashtu edhe QMF. Për DSHëndetësisë dhe për mua personalisht paraqet obligim riorganizimi i QMF-së në Bresanë lidhur me shërbimin 24-orësh shëndetësor, pasi se atje, vërtetë, ka numër të madh pacientësh e për shërbime në Dragash është mjaft larg. Po ashtu, është nevoja që, në çdo ambulancë, të dërgohet mjeku me personelin përcjellës apo teknikun e jo që gjithçka në ambulanca të lehet në nëdërgjedjen e teknikëve, që të punoj siç duhet e munden?

z.Laurat Krasniqi- Vitin e kaluar, nga Komuna janë ndarë mjete për kubëzime në f.Pllajnik, për çka Zyra e Prokurimit ka hapur tenderin për mbulesën e tyre gjatë vitit 2017, por që punët nuk kanë përfunduar e për këtë dikush duhet të bartë përgjegjësi, kryetari i Komunës apo Komisioni për Pranim Teknik të Punimeve, që për këtë kërkoj një Raport shtesë. Athua me formë të njejtë veprohet edhe për Stadiumin e Qytetit, kur u ndan mjetet vitin e kaluar e janë bërë shumë pak investime e që nuk do të kushtonin mbi 15 mijë euro e që projekti po vazhdon të realizohet, nga viti në vit, që sot kemi ardhur në situatë të kemi një investim në të cilin janë gjuajtur 200-300 mijë euro? Ai Stadium është i kapacitetit të madh, më i madh se sa na nevojitet realisht e, për te, nuk janë bërë analiza paraprake e punët janë pranuar si të tilla?!

z.Selman Osmani- z.Velid H. unë nuk ju drejtova juve, por i bëra pyetje kryetarit dhe drejtorëve të drejtorateve e, herëve tjera, nuk dëshiroj të dëgjoj për intucionet paralele dhe kush punon në to? Unë këtu jam në emër të JGP-së dhe kam 1.300 vota për dallim nga ti e mos të hyjmë në diskutime tjera.

z.Velid Haxhisin- Vetëm t'i ulim tensionet e unë këtu u paraqita në emër të kryesuesit të GP "Vakat" e ju i përmendët ato institucione-zyra që qenkan shëndërruar në të "Vakatit" e nuk ju përmenda juve në kontekst të institucioneve paralele.

Kryetari- Kur flasim për Raportin dhe planet e punës, ju kisha lutur që të orjentohe mi në këto dokumente dhe pa kualifikime politike. Z.Selman O. parashtroi pyetje reth shëndetësisë dhe këtu i kemi drejtorët dhe është e pashmangëshme nevoja që të bëjmë punësime të reja, duke pasur parasysh faktin e pensionimit të tyre dhe psh.vëretë, është shqetësuese që, qe nga viti i kaluar, nuk kemi gjinekolog-e, edhe pse jemi në kontakte të vazhdueshme me QSpitalore në Prizren dhe Ministrinë, siç është shqetësuese edhe çështja e furnizimit me insulinë si barë esencial i cili, edhe po deshe, nuk mund të sigurohet në barnatore private, siç është shqetësuese edhe gjendja me shërbimet shëndetësore në ambulancën e Restelicës, me një mjek e teknik, pasi se mungojnë kuadrot e nevojshme për nevojat në shtim atje. Sa u përket kualifikimeve në QPS, mendoj se atje punojnë kuadrot adekuate e për ndojërin që zëvendëson dike duhet bërë analiza në bahkëpunim me DQPS. Ndërkaq, sa i përket ujës-jellësit qendor, ai do të kryhet. Lidhur me diplomat në shkollën e Krushevës mendoj se këtë e ka në kosideratë DDKA-së e që janë angazhuar, ndoshta, në munegesë të kuadrove, mund të ketë zëvendësime, por që janë respektuar procedurat. Në anën tjetër, sa i përket Zyrës së Komuniteteve në Krushevë, mendoj se duhet anashkaluar kualifikimet politike se a janë aty prezent anëtarë të "Vakat-it" apo të ndobnjë subjekti tjetër politikë, por është normale që institucionet shtetërore nuk duhet të shfryrtëzohen për qëllime partiake e që mendoj se punëtorët që punojnë aty këtë e kanë parasysh. z.Sefidin M. e shprehu shqetësimin me rrugët që është gjendje vërtetë problematike e për disa kubëzime që po keqpërdoren, edhe përkundër të një Vendimi që kjo mos të ndosh për kubëzimin e pronave private. Sa u përket projekteve për vitin 2017 të përcjell në vitin 2018, ata do të përfundojnë sivjet. Ndërkaq, ndërlidhjes së projekteve me zgjedhjet, kjo ndoshta ka qenë

dukuri më herët, por jo me këto të fundit lokale. Siç theksova, çështja e gjinekologut-es që mungon na shqetëson, por, mjerisht, është ashtu, siç brengos edhe përcjellja e pacientëve, me shofer e pa teknik, në QS në Prizren e që shpresojmë që këtu të vendoset njëfar regulli. Te çështja e paraleles parashkollore në f.Rrencë, këtë e ka marr përsipër DDKA-së që gjendja të zgjidhet, nga shtatori, në harmoni me nevojat buxhetore, kudo ku ka mundësi për paralele të tilla. Sa u përket vendosjes së kubëzave në f.Pllajnik. Kjo çështje do të zgjidhet sivjet, pasi se janë mjetet e nevojshme për to.

z.Shepetim Hajredini- Edhe pse u fol mjaft për DShëndetësisë, unë do të ndërlidhem me DKRSportit që nuk qenka paraparë ndonjë manifetim për Ramazan-Bajram e ne këtu jemi 99% muslimanë dhe dëshiroj të citoj thënien e Albert Ajnshtajnit se në "një shtet ku gjykatat humbin të drejtën, shëndetësia humanizmin e arsimit humb cilësinë, lëshojeni atë vend se, vërtetë, është keq"! Po shpresoj që kjo thënie e Ajnshtajnit mos të vlen për shtetin dhe komunën tonë?

Kryesuesi- Kalojmë në votimi dhe kush është "për"-14, "kundër"-8 dhe të "përmbajtur"-0 vota, që pra miratohet materiali i kësaj pike.

Pika e III-të (tretë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën dhe në kuadër të kësaj pike tani e kemi shqyrtimin dhe miratimin e Raportit të Punës së KKS-së, për vitin 2017 dhe P/Veprimit, për vitin 2018 dhe, siç e dini, ky material është shqyrtuar e miratuar në mbledhjen e KKS-së dhe komitetet obligative e ky Këshill është organ i themeluar nga Kuvendi i cili duhet të informohet për punën e tij, hapim diskutimet...?

z.Samidin Xheladini- E përkrahi këtë dokument i cili ka anët pozitive dhe negative për të cilat e lëndojmë dhe i kritikojmë. Në fq.e 1-rë të Raportit theksohet se është dashur të mbahen 6 takime e janë mbajtur 4 e që si arsy përmenden zgjedhjet lokale e që Këshill ka pasur legjitimitet të mbaj takime deri në fund të vitit. Po ashtu, në Raport përmendet bashkëpunimi i mirë ndëretnik në mes të dy komuniteteve në Komunë, që, me këtë rast, e përgëzoj e që besoj që ky bashkëpunim të thellohet. Në faqen tjetër kemi një Tabelë ku janë përfshirë detajet e rasteve me 71 vjedhje e një vit më herët 82, si dhe zvogëlim të veprave kundërvajtëse nga 90 në 24. Dhe, nëse gjendja është ashtu siç është pasqyruar në këtë dokument, e këto janë dokumente zyrtare, kjo është në rregull, por një gjë që brengos është se qytetatrët ngurojnë të paraqesin rastet e vjedhjeve e nuk janë zbuluar kryesit e tyre?! Pra, Policia po i arreston kryesit e veprave e po i dërgon para drejtësisë, por, pastaj, ata po lirohen nga gjykatat e ata që i paraqitën vjedhjet u vunë në pozitë të palakmueshme?! Në fq.3 përmendet roli i Këshillit në bashkëpunim me këshillat lokale e ai Këshill po funksionojka vetëm në Krushevë, dhe atë qe 10 vite, e që pra duhet të themelohen këshilla të tillë lokal edhe nëpër lokalitete tjera. Në fund, flitet edhe për mungesën e ndërgjegjes reth higjienës përmes gjuetjes së pakontrolluar të mbeturinave e që kjo mbetet kompetencë e DEmergjencës që të organizon grumbullimin më efikas të tyre nëpër deponi e që kjo çështje është dashur të përfshihet edhe përmes Planit të Veprimit, për vitin 2018. Po ashtu, kërkoj që lidhur me çështjen e qenëve endacak e cila

brengos, e që është dashur të hartohet në Plan konkret për zgjidhjen e problemit, pasi se shumë qytetarë pë ankohet për këtë dukuri, siç po ankohen edhe reth deponive dhe mungesën e këshillave lokale të sigurisë nëpër fshatra tjera.

z.Rexhep Kamberi- Unë e përkrahi këre Rapor të Plan, por te Plani-me nr.rendor 4 lidhur me problematikën e qenëve endacak, e përkrahi parafolësin që të kemi Plan konkret për zgjidhjen e këtij problemi e që kjo të jetë çështje urgjente. Këtë e theksoj nga arsyeja se, brenda 2 muajëve të fundit, kemi 2 raste të sulmit të këtyre qenëve endacak me lëndime serioze të njerzëve...Qerdhja e ndodhjes së këtyre qenëve endacak është tek QKMF-ja dhe QPS-ja e që, gjatë ditëve të tregut-të premteve, po kemi rastin se qentë e tillë(këlysh) po sillen nga qytetarë të fshatrave fqinje të Shqipërisë. Për këtë, apeloj tek Policia Kufitare që të merren me këtë problematikë, përmes shtimit të kontrollimeve kufitare. Ne këtë e kemi theksuar edhe dje në KKomunitet ku është thënë se me çështjen do të merret AUVeterinës, por që procesi po shkon ngadal?

z.Zinaida Elmazi- Pasi se çështja e sigurisë është me rëndësi dhe kemi nevojë të informimit, unë në KKomunitete kërkoja që të gjithë delegatëve na dërgohen procesverbalet e komiteteve?

z.Nexhat Isufi- Pasi po flasim për sigurinë, e që ka të bëj me sigursinë në bashkësi, përmes KKomunitet kërkoj të bëhet Kërkesë për hartimin e një Plani të Veprimit reth problematikës së qenëve endacak. Unë e di që cila është zgjidhja e kësaj problematike-përmes eliminimit, por që nuk po e them haptas, pasi se ka pangesa ligjore e dihet se kemi "x" raste të rrezikimit të qytetarëve nga këta qenë endacak.

z.Vehbi Nazifi- Sa u përket qenëve endacak, ndoshta, unë-si vereiner jam më i turrur për të folur për këtë çështje. Për këtë problematikë, biseduam edhe dje në KKomunitete dhe po theksoj se ajo çështje ka kaluar nën kompetencën e organeve qendrore-Qeverisë e cila ka shpallur tenderin për t'u siguruar kompanitë për zbatimin e këtyre procedurave e mjetet janë paraparë në shumë prej 1,3 milionë eruro. Dhe, siç e dini, nuk guxon të aplikohet eliminimi klasik i tyre-me vrasje, pasi se ka dispozita ligjore lidhur me procedurat reth grumbullimit, kastrimit etj e mos të humbim tani kohë me këtë që e ka marr përsipër Qeveria e Kosovës e, po të donim, ne si qeveri lokale, të ndërmarrim diçka në suaza ligjore kjo do të kishte kosto të lartë e që ne duhet paraparë ndryshime në kategori buxhetore.

Kryetari- Lidhur me Raportin-2027 dhe P/Veprimit të KKS-së-2018, unë lidhur me diskutimet që dominuan reth qenëve endacak, pajtohem se ky rezik vërtetë ekziston, kurse mbajtja e 4 takimeve në vend të 6 takime të KKS-së, është ashtu siç theksohet në Raport, nga shkak i mbajtjes së zgjedhjeve lokale, kur pushuan aktivitetet. Sipas tabelës, në Raport, vërehet diku shtim e diku rënie të veprave, që marr në tërësi, gjendja e sigurisë te ne është mjaft stabile e që ishte falë bashkpunimit të organeve të rendit me qytetarë dhe këtë Këshill. Po ashtu, është theksuar nevoja e respektimit të orareve të punës nëpër lokale publike-sidomos gjatë verët, si vetëdijesimi në mirëmbajtjen e

higjienës, siç po na brengosin qent endacak ku ka probleme ligjore me eliminimin klasik të tyre e që problemi është ngritur në nivel qendror-Qeverisë dhe, për këtë, në komunën tonë, përmes AVeterinës, janë anagzhaur 2 veteriner e që efektet i presim lidhur me trajtimin e tyre, kurse kërkesa për "azil" të tyre, te ne, nuk janë aplikuar, nga se nuk kemi kushte reale dhe kosto të mbulimit të shpenzimit të tyre, pasi është ardhur në përfundim se një trajtim i till i një qenë kushton diku 20,00 euro. Pra, siç do të zgjidhet rasti i tyre në nivel gjithkosoar, do të veprohet edhe te ne, kurse brengos edhe fakti që e theksoi z.Rexhep K. se qentë-këlyshët e tillë po sillen edhe nga fshatrat fqinje të Shqipërisë.

Kryesuesi- Kalojmë në votim dhe kush është për miratimin e klëtyre dokumenteve të sigurisë..."për"-19, apo shumica, që pra miratuam këto dokumente.

Pika e IV-të (katërtë) e rendit të ditës

Kalojmë në pikën e IV-të rendit të ditës-shqyrtimi dhe miratimi i Raportit 3-mujor financiar/2018 dhe lidhur me këtë fjalën e ka kryetari z.Shaban Shabani, urdhëroni z. kryetar...

Kryetari- "Bazuar në nenin 58 pika J e Ligjit 03-L/40 mbi Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.20/2008 te datës 04.06.2008) dhe nenin 45.4 të ligjit 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (Gazeta Zyrtare e Republikës se Kosoves nr.27/2008 të datës 03.06.2008) paraqes një përmbledhje të shkurtër të raportit tremujor financiar për realizimin e buxhetit janar-mars 2018.Raportet financiare tregojnë informacione lidhur me buxhetin, rrjedhën e parasë së gatshme, të hyrat, pagat, shpenzimet për mallra dhe shërbime, shërbimet komunale, subvencionet dhe transferet, dhe shpenzimet për investime kapitale Ky Raport financiar prezanton të hyrat dhe shpenzimet e muajve janar-mars dhe bënë krahasimin me muajt e njejte të 2 viteve paraprake.Buxheti për vitin 2018 është miratuar ne Kuvend në shumën prej 8,069,990.00 euro, pas bartjes së të Hyrave Vetanake të pashpenzuara të vitit 2017 në shumën prej 637,935.10 euro dhe të hyrave nga Fondi i Donatoreve të vitit paraprak në shumën prej 13,028.65, buxheti komunal në periudhën raportuese arrinë shumën 8,720,953,00 euro.Pagat dhe shtesat- pagat janë më të larta ne krahasim me periudhën raportuese të vitit paraprak për arsye te rritjes se pagave prej 4 % dhe rritjes së përvojës së punës.Shpenzimet për mallra dhe shërbime- janë me te larta për 114 % dhe kjo është një formë e mirë e menaxhimit të buxhetit pasi qe vitin paraprak nga kjo kategori janë kthyer mjete me vlere rreth 203,010.92 euro dhe kjo na pamundëson kërkesën për rritje të buxhetit.Shpenzimet komunale- janë më të larta për 9.51 % në krahasim me periudhën raportuese të vitit paraprak. Kjo rritje është bërë pasiqe janë paguar disa fatura të ujit për vitin e kaluar.Subvencionet dhe transferet-janë më të larta për 69 % në krahasim me periudhën e njejte raportuese te vitit te kaluar. Në këtë vite janë bërë pagesa më shumë për shkak të disa rasteve emergjente.Shpenzimet për investime kapitale- në këtë kohë të raportimit të shpenzimeve, investimet kapitale janë ne fazën e lidhjes se kontratave dhe zhvillimit te punimeve. Deri më tani janë lidhur 20 kontrata dhe 15 projekte janë ne procedure te tenderimit.Të hyrat vetanake të komunës- janë më të larta për 9.39 % ne krahasim me periudhën e njejte të vitit të kaluar. Në tabelë shihet se certifikatat e lindjes, vdekjes, kurorëzimit nuk janë të nivelit të pritshëm por programi këto i regjistron si Taksa tjera të ofiqarisë."

z.Nexhat Isufi- Ne duhet t'i shqyrtojmë raportet e kryetarit dhe organeve tjera komunale e në 6-mujor do të kemi edhe atë financiar ku do të shifen saktësisht gjërat reth financave se psh. në fq.3 ku flitet për regjistrat e pagave ajo , si kategori, është e ngjajshme si me atë të vitit paraprak e në fq.4 kemi dallim? Në njerin nga kodet reth shpenzimeve të internetit, gjatë 3-mujorit, janë hargjuar 1.090,00 euro e vitin e kaluar vetëm 60,00 euro e nën këtë kategori shpenzimet e telefonisë mobile "Vala" e kemi një dallim prej 2 mijë eurove. Te kodi 13780 karburanti për automjete kemi një shqetësim dhe s' di se ku ka munduar të hargjohen 10 mijë euro më shumë? Pra, këto qytetarëve duhet t'u sqarohen. Te kodi 1406 "mirmbajtja rutinore" dëshiroj të më sqarohet se çka nënkuptohet e kjo është shumë prej 1000.600,00 euro? Kështu, lidhur me drekat zyrtare kemi shtim nga viti paraprak e kemi të bëjmë me të njëjtat festa? Në fq.6 te investimet kapitale, cili është ai projekt i cili ka kushtuar 25 mijë euro e nuk janë paraqitur shpenzimet, pos të një projekti me donatorët, në këtë rast me UNDP-në projekti 3-vjetor, për të cilin nuk dijmë, e i cili paska kushtuar 25 mijë euro?!

z.Sevim Avdullahi- Në Raportin të cilin e kemi në Kuvend më vjen mirë nëse mjetet janë hargjuar për të mirën e qytetarëve e jo të këthehen në suficit, ashtu siç ka ngjar vitin e kaluar e dihet se kërkesat e qytetarëve janë të mëdha. Por, me rastin e analizës së materialit, vërejtja të kundërtën, pasi se janë hargjuar mjetet që janë në Raport janë mjete luksoze dhe akomodime dhe atë nga ana e zyrtarëve të Komunës, për disa pozicione, e jo për të mirën e qytetarëve. Raportin që e kemi tani, kur krahasohet me ata të mëhershmit nga pushteti i kaluar, nuk mund të krahasohet në aspektin e shpenzimeve. Psh.shpentimet për udhëtime zyrtare dhe akomodim të zyrtarëve janë 780,00 euro e në vitin 2017 nuk u hargjua asnjë cent? Është mirë që paskan udhëtuar se qytetarëve ju nevoiten udhëtimet, por do të presim rezultatet se çka me ato udhëtime, pas 3 muajëve? Për udhëtimet jasht vendit në vitin 2018 keni hargjuar afro 6 mijë euro e në vitin 2017 asnjë cent?! Kategoria e mobiljeve, në vitin 2018 është 1.100,00 euro e në vitin 2017 asnjë cent e te kategoria e ushqimit e pijeve ajo duhet t'u sqarohet qytetarëve, sepse mendojn se edhe në këtu po hajmë dhe pimë? Për vitin 2018 për këtë kategori keni hargjuar 2.100,00 euro e në vitin 2017 janë hargjuar 290,00 euro. Shpenzimet për kaburant të automjeteve në vitin 2018 janë 14 mijë euro e vjet 5 mijë euro, që paraqesin dallim të madh? Mirëmbajtja e automjeteve në vitin 2018 reth 7.400,00 euro e në vitin 2017 – 1.200,00 euro. Shpenzimet e ujit në vitin 2018 janë 5 mijë euro e në vitin 2017 - 1.800,00 euro e qytetarët ju kanë votuar dhe dhënë pushtetin dhe a po e udhëheqni mirë këtë Komunë?! Mjerisht, këtë po e theksoj, edhe pse jam nga e njeta parti politike-PDK-ja nga e cila është edhe kryetari, por që këto janë probelmat me të cilët, vërtetë, po ndeshemi.

z.Samidin Xheladini- Mua më vjen mirë që, për herë të parë, që dikush nga partia në pushtet po kritikon dhe po flet kështu. Këtë nuk po e theksoj nga inati, por nga shikimi real i kategorive nga Raporti. Unë në fq.3 të Raportit kam kërkuar që të na dërgohen listat e pagave, pasi se punëtorë të caktuar nuk kanë dokumentacion përcjellës, që pra nuk paguhen përmes listës e janë hargjuar diku 26 mijë euro më shumë se më parë e që e kemi kërkuar këtë edhe më herët. Në fq.4 te shpenzimet e udhëtimit jasht vendit 1.164,00 euro pao 250% më shumë e fjala është për 3-mujorin. Te shpenzimet

e internetit kemi shtim në 1.090,00 euro e vitin e kaluar shpenzimet ishin 60,00 euro. Te telefonia mobile "Vala" 5.274,00 euro këtë vit e në vitin e kaluar 3.509,00 euro apo 150% më shumë. Shërbimet kontraktuese pse po ngjajnë, apo janë në pyetje faturat e papaguara që janë dorëzuar më vonë e është shumë prej 19.225,00 euro ku vjet kanë qenë 5.996,00 euro e që është dallim i madh me diku 32% më shumë. Te furnizimi me material zyreje kemi shumë prej 4.170,00 eurove e që vitin e kaluar ishte 1.650,00 euro, te furnizimi me ushqim e pije, është kategori për të cilën duhet pasur kujdes, e mos të ngaj që këtu të na përzijenë edhe neve? Z.Kryetar, dëshiroj t' parashtroj pyetjen reth thëngjillit apo druve e këtu shofim kolona të zbrazëta dhe athua nuk paska pasur pagesa këtu e që duhet ndërmarr masa për furnizim me kohë të shkollave me këto materiale të ngrohjes. Njëri nga kolegët përmendi karburantet për automjete e që, këtë vit, kanë qenë 14.188,00 euro, e në vitin 2017, në 5.904,00 euro apo 240% më të larta, që do të thotë se me këtë kategori po vazhdohet me të njejtin trend që karburantet të shpenzohen, siç janë shpenzuar edhe më herët? Ne kemi folur reth këtyre çështjeve dhe nëse ekzistojnë automjete të vjetëruara që hargjojnë më shumë karburante, atëherë do të ishte e udhës të sigurohen automjete të reja, apo mos është në pyetje keqpërdorimi i karburanteve?! Po ashtu, kam vërejtje edhe te kategoria e mirëmbajtjes së automjeteve në shumë 7.444,00 euro e vitin e kaluar 1.218,00 euro, të na jepen sqarime se si mbulohet kjo kategori, ku dallimi është 611% më i lartë?! Dikush e përmendi edhe "mirëmbajtjen rutinore", të jepen sqarime se për çka është fjala dhe për shpenzimet e bëra? Edhe te drekat zyrtare dallimi 1.96,00 euro nga viti i kaluar, kur ato ishin 616,00 euro? Ajo që është më interesante janë zbatimi i vendimeve gjyqësore në shumë prej 7.558,00 euro që është shumë e lartë për të cilën kam folur edhe më herët?! Shpenzimet duhet paguar, por në vitin 2017 nuk kemi pasur shpenzime të tilla e tani në 3-mujor 7.500,00 euro e kjo paraqet pagesën e shpenzimeve për konteste gjyqësore e që janë humbur në dëm të Komunës?! Kjo është për shkak të mospunës së organave kompetente komunale që nuk kanë qenë në nivel të detyrës. Po ashtu, kemi kërkuar që të na dërgohet Lista e Subvencioneve, që organet komunale të janë transparente. Gjitashtu, dua të theksoj se te pagat e shtesat fq.6 kemi diku 33 mijë euro më shumë nga viti i kaluar e për çka ka ngjarë kjo? Ndërkaq, për të mos ngjarë se vetëm po kritikojmë, në fq.7 ka një lavdatë lidhur me inkasimin e mjeteve nga të hyrat vetanake që janë 9,39 % më të larta nga viti paraprak, apo 6 mijë euro më shumë e që paraqet qasje pozitive e cila duhet vazhduar e kjo është në të mirën tonë dhe atyre që kanë paguar obligimet.

z.Laurat Krasniqi-Në këtë Raport vërhen shtime të shpenzimeve dhe, marr në tërësi, nëse bazohemi në shifra kemi një shtim prej 120% e dikush nga kolegët përmendi mirë është që është filluar me shpenzimet e mjeteve, sepse ndryshe ato do të këtheheshin në suficit, por që kjo duhet të jetë shpenzim racional e jo siç shpenzohen tani. Vërtet, disa kategori janë më të larta dhe unë nuk jam kundër vizitave zyrtare të ekzekutivit, por parashtrohet pyetja se çka u sjellin qytetarëve ato vizita e kemi shtim prej 100%? Po ashtu, për kategorinë e shpenzimeve të karburanteve kemi shtimin prej 200% e kjo është çështje që brengos e në anën tjetër kemi zvogëlimin për karburante të nxemjes qendrore e unë për vitin e kaluar kam përmendur se nafta diku "po pikon", ju këtë nuk e keni kuptuar seriozisht? Vitin e kaluar, nëse ju kujtohet, për këtë janë hargjuar 60 mijë euro e tani në 3-mujor 5

mijë euro e sidoqoft në katë kategori nuk mund të hargjoheshin 30 mijë euro, e që kuptohet se pushteti lokal ka ndërruar strukturën dhe udhëheqësinë, por nuk nuk e ka ndryshuar mënyrën e udhëheqjes së Komunës. Pra, ky këto shpenzime prej afro 120% në tërësi, janë shqetësuese z.Kryetar e që duhet të merreni seriozisht.

z.Shpetim Hajredini- Shumica e kolegëve folën në mënyrë kritike për Raportin e unë jam për lavdata të tij. Ato lavdata kanë të bëjnë me atë se kemi të bëjmë me shtim të hyrave vetanake për 9,39% e që paraqet meritë për drejtorin dhe për tërë strukturën komunale në krye me Kryetarin. Edhe një çështje që më bënë të lumtur është grumbullimi i qirasë në pronësi komunale ku ka pasur të hyra prej 8.488,00 eurove e që paraqet dallim të madh me intervalin e vitit paraprak kur kishte 2.271,00 euro, apo me përqindje, dallimi në shtim të qirasë për 373%. Për lavdatë janë edhe dënimet në trafike kjo më së shumti ka të bëj me lavdatat ndaj Policisë së Kosovës.

z.Zaim Hajredini- Sa i përket Raportit ka gjëra të paqarta, që nuk do të thotë se ka keqpërdorime në disa kategori. Pasi se flitet për buxhetin në miliona mund të ketë edhe paqartësi në 2-4 faqet e tij. Por, rendi e qon që ne të flasim me fakte e shifra e jo me dyshime të cilat krijojnë debate të paarsyeshme. Unë pajtohem me disa për kërkesë të sqarimeve. Lidhur me grumbullimin e qirasë komunale ne, me vite, vite kemi apeluar e lobuar për grumbullimin e tyre e që tani kjo kategori po reflektohet me suksese. Po ashtu, edhe te të hyrat vetanake. Ajo që më së shumti kam dyshuar e që dola në foltore është se, viteve të kaluara, kemi pasur vonesa në alokimin e mjeteve e që është reflektuar pozitivisht me angazhimin e kryetarit të ri që, bie fjala, për furnizime mjekësore, vitin e kaluar. nuk kishim, apo çka do të thotë? Ne tani jemi dëshmitarë se disa nga projektet investuese tani më po realizohen e kjo nuk ka qenë rast më herët e këtë e dinë ata që kanë qenë këtu më herët dhe nëse në 3-mujor kemi pasur 64 mijë euro investime, në 6-mujor do të kemi do të kemi edhe më shumë. Unë, kështu, nuk po dëshiroj të mbroj askend, por të shiqohen gjërat ashtu siç janë e jo vetëm të kritikohet. Pra, gjërat janë për lavdata dhe në këtë merita ka edhe ky Kuvend, pasi se ne jemi ata të cilët kemi ndikuar në investime që të fillohet më herët me realizimin e tyre, kurse ajo se a janë apo jo në rregull shpenzimet, me këtë duhet të merret dikush tjetër, kurse unë e përkrahi secilin i cili punon në pengimin e keqpërdorimeve e mjeteve vetanake, përkatësisht parasë publike. Dhe, nëse ekziston cili do nga shërbimet që ka hargjuar pa nevojë, përkrahi ata që janë kundër tyre.

z.Valon Shabani(DDEF-ca)- Ky Raport 3-mujor që e keni është pa kurrfar fshehje dhe manipulime dhe është tejet i saktë dhe si të tillë e kemi paraqitur para jush. Ky Raport flet për shpenzimet Janar-Mars 2018 dhe për çfardo dyshimi e paqartësi mund të vini te ne në Drejtorat e në program kem të gjitha shpenzimet që mund të bindeni e të merrni rezultatin. Kategori e parë në këtë buxhet janë pagat, e siç e dini, pagat janë shtuar për shërbuesit civil në shkallën 4,5%, si dhe ajo se për çdo vit punëtorëve u shtohet nga një vit i përvojës së punës. Shumica e pyetjeve ishte reth mallërave shërbimeve të cilat 13.330,00 euro janë shpenzime të udhëtimit në vend dhe dëshmoj se asnjë zyrtar komunal i cili shkon deri në Prishtinë apo kudo në Kosovë nuk merr mëditje e këto

shpenzime janë nga transporti i nxënësëve nëpër Kosovë e pastaj shpenzimet për udhëtime jasht
cvendiot në shumë 608,00 euro janë paguar nga buxheti Zyrlës së Kryetarit e ato janë për ata që
udhëtojnë jasht Kosovës e u takon mëditja, si dhe paguhet një shumë e mjeteve vetëm për shoferët
që udhëtojnë zyrtarisht e e kanë koeficientin e pagës të ulët. Këtu hyjnë edhe shpenzimet e zyrtarëve
të Komunës, si kryesuesi i Kuvendit, kryetari i Komunës dhe një zyrtar për bujqësi që kanë udhëtuar
zyrtarisht në Austri, me autobus, e jo si më parë, me avion. Te shpenzimet e interenetit, shumicën e
tyre e kanë bërë shkollat e, siç e dini, të gjitha shkollat kanë internet e që janë shpenzime nga viti i
kaluar e ju që keni qenë më herët pjesë e Kuvendit, siç e përmendi z.Zaim H. e dini se buxheti është
me kode e kanë qenë të planifikuara 100,00 euro e ato janë grumbulluar nga zyrtari financiar i arsimit
për t'u paguar faturat e vitit të kaluar e në shkolla ka pasur borje nga viti i kaluar. Te shpenzimet e
telefonisë mobile "Vala", siç e dini, kanë të bëjnë me mbushjet që merrni ju, drejtorët dhe shefat e
sektorëve në Komunë-me vendime përkatëse, si dhe shpenzimet në kuadër të rrjetit intern telefonik
të zyrtarëve të Komunës. Shërbimet teknike janë nëpër shkoll, si psh.në Bellobrad ujësjellës etj. e që
mund të bindeni në shënimet e faturat në Drejtorat e që, nëse doni ,edhe përmes formimit të ndonjë
komisioni për këtë çështje. Te shërbimet kontraktuese, mund të them se 90% janë ato shpenzime që
paguhet për punëtorët e angazhuar me kontratë, siç kemi pasur rastin tek Zjarrfikësit me punëtorë
të angazhuar sezonal për pastrimin e borës. Këtu kemi edhe kategorinë e pensionistëve që u paguhet
paga me rastin e pensionimit të arsimtarëve, që u paguhet 3 paga me mesataren diku 1.400,00 euro,
apo për intervenime infrastrukturale, si në Restellicë e Kuk. Te paisjet shëndetësore, po theksoj se
vitine kaluar është nënshkruar një Kontratë për furnizim me barna e që ajo vazhdon për 3 vite me
shumën prej nga 1 mijë euro për material laboratorik.. Te kategoria e furnizimit, me mobile nën 1 mijë
euro, këto janë paisje për drejtorate...Shpenzime tjera janë bërë në sh.f."Shaban Shababni" të
Llopushnikut ku është rinovuar salla e arsimtarëve, kurse psh.furnizimi me naftë për ngrohje është në
rënie e që kjo varet nga arritja e faturave gjatë vitit, siç kemi rastin me një faturë të vitit të kaluar në
shumë prej 4 mijë eurove. Te shpenzimet e karburantit duhet pasur parasysh se, pothuaj se çdo ditë,
nga 2-3 vetura udhëtojnë zyrtarisht për në Prishtinë e vende tjera, si dhe ato shpenzime që bëhen për
autobus me rastin e transportimit të klubeve sportive që i mbështesim dhe për transport të nxënësëve
nëpër disa fshatra. Sa u përket mirëmbajtjeve të automjete, aty ka shpenzime si pasojë e vjetërisë
së automjeteve, kurse ekzekutimi i vendime gjyqësore ka të bëjë me aktvendime të gjykatave për
çfardo shkelje ligjore, qoft edhe mospagesa me kohë e ndonjë fature për hapjen e rrugës në Krushevë
prej 2 mijë eurove të realizuar përmes gjykatës, pastaj pagesa e 2 rasteve përmes gjykatës e ka të bëjë
me aktvendime të gjykatave për çfardo shkelje ligjore, qoft edhe mospagesa me kohë e ndonjë fature
për hapjen e rrugës në Krushevë prej 2 mijë eurove të realizuar përmes gjykatës, pastaj pagesa e 2
rasteve përmes gjykatës për mospagesën e pagave jubilarë të arsimit. Sa u përket shpenzimeve për
ushqim e pije e dini se e kemi pasur Ditën e Pavarësisëdhe nga Zyra e Kryetarit janë shpenzuar 800,00
euro për pjesëmarrësit në festival me nga 3,00 euro për një racion. Zyra për Komunitete e Kthim i ka
hargjuar 300,00 euro për mbështetje që u bënë disa personave të riatdhesuar dhe të këthyer, pastaj
shënimni i 8 Marsit-Ditës së Gruas me shpenzime nga DEF-ca e që kanë qenë prezente në koktel 40-

50 gra, si dhe organiozimi i koktejeve për disa punëtorë të Komunës që kanë shkuar në pension. Edhe me UNDP-në kemi kontaktë për realizim të projekteve, ku Komuna vjet ka pasur obligim të paguan 25 mijë euro e sivjet 20 mijë euro e që është sufinansim me donatorët. Këtu është sufinansimi për përkrahje fermerëve përmë ndarjes së mjedrave, bletëve dhe mëshqerrave e që nga komuna janë dëku 100 përfitues të këtyre granteve. Për shpenzimet e ujit e kuptoj se janë të palogjikshëm e që janë më të mëdha se sa për ushqim e këto janë 2 fatura nga viti paraprak. "Mirëmbajtja rutinore" është kategori buxhetore për intervenime të shpejta e që që shkohet përmes procedurave të prokurimit nëse tejkalohe 100,00 euro, si psh. nëse prishet kompjuteri, apo ndonjë paisje tjetër me të cilat bllokohet puna e përditshme zyrtare. Shumicën e këtyre shpenzimeve e kanë bërë shkollat si psh.thyexja e xhamave, intervenime në ujësjellës, kanalizime, dyer, dritare etj.

z.Nexhat Isufi- Mendoj se nuk e mora përgjigjen adekuate lidhur me pyetjet reth internetit dhe dëshiroj të theksojs e shkollat a kanë pasur këto lloj shpenzimesh gjatë 3-mujorit të njejt të vitit të kaluar, pasi se është dallim i madh në shumë prej 1 mijë euro. Shërbimte kontraktuese, me sa më kujtohet, vitin e kaluar ka pasur të punësuar me kontrata mbi veprën, apo fjala është për këtë 3-mujor e u përmendën disa borgje nga viti paraprak që janë përcjellur në këtë vit dhe a janë në plan të paguhen borgjet e vitit të kaluar të përcjellur në këtë vit?

z.Samidin Xheladini- Po e shof se drejtori qenka përgatitur dhe i dëshiroj sukses, pasi se ishte mjaft konkret dhe, po të merrnim përgjigje të këtilla më herët, nuk do të kishte komente të ndryshme për gjëra të pa qarta dhe të besoj se të gjithë jemi të kënaqur me diskutimin tuaj. Ate që desha të them është të jeni të kujdeshëm, pasi se juve u vijnë faturat e fryra e ju t'i paguani me procedura, pasi se këto janë para publike. Mos të mendoni se ne këtu kritikojmë nga ndonjë inat, por dëshirojmë që proceset të shkojnë në mënyrën më të mirë të mundëshme. Psh.punëtorët me kontrata nuk i intereson, por ky është obligim i ekzekutivit, por ekziston dyshimi se pranohen të atillë me kontratë të afërt me partinë në pushtet e lëtu lindin dyshimet e po favorizohen e privilegohen grupe të caktuara të njerëzëve. Nëse këtë do të mund të frenonim, do të ishte më lehtë të punohet. Po a shtu, lidhur me automjetet dhe karburantin, ju kisha lutur të jeni të kujdeshëm kur ju sjellin fatura të fryra e me shumta të mëdha, që të dihet se a kanë bazë dhe të verifikohen?

Kryesuesi- Pasi se nuk kemi diskutime tjera, kalojmë në miratimin e kësaj pike të rendit ë ditës dhe kush është "për"-17, "kundër"6 dhe 0 vota "të abstenuara", që pra miratohet Raporti 3-mujor Financiar/2018.

Pika e V-të (pestë) e rendit të ditës

Në pikën e V-të kemi shqyrtimin dhe miratimin e Kërkesës së z.Lulzim Rifaj lidhur me Projektin për Planin Regullativ në parcelat 1521 dhe 301/3 në Dragash dhe, ju tëheq vërejtjen se sot jemi në seancën e 5-të dhe, deri tani, askujt nuk ia kam shkurtuar e censuruar kohën e diskutimeve. Por, për këtë ekziston Rregullorja e Punës së Kuvendit, të cilin, asnjëri nga ju, nuk po e respektoni. Ju letem që

t'a respektoni ate dhe vetëvehten e këtë ua them që mos të teprohet me disa gjëra dhe për shkak të kohës që kemi, hapim diskutimet...

z.Laurat Krasniqi- Unë jam hera e parë delegat i Kuvendit dhe nuk e di se a ka Komuna Plan Regullativ. Drejtori i DUrbanizmit nuk e ka parë të udhës që të na njoftoj këtu lidhur me këtë çështje?! Unë nuk jam inxhinier me profesion dhe nuk barti përgjegjësi reth kësaj çështjeje e duhet të dihet se çka më tej?Kemi 2 kërkesa ku njeri është për ndryshim të destinimit të tokës e tjetra për leje ndërtimi apo liçencë. Lejet nuk i jep Kuvendi Komunal, ato i lëshon Durbanizmit dhe atij është dashur t'i adresohet Kërkesa. Ne mund të votojmë e japim Pëlqim për Planin regullativ-Urban, por të ketë sqarime nga ekspertët e fushës, që t'i marrim parasysh rekomanimet e të veprojme edhe ne. Unë, si delegat i Kuvendit, si delegat i ri në Kuvend, kam dilema reth kësaj çështjeje. Psh.Kuvendi Komunal i Prishtinës askujt nuk i jep leje se a duhet ndërtuar ndonjë objekt apo jo e DUrbanizmit është ai i cili jep leje të tilla e ata e kanë PUrbanistik në bazë të të cilit është bërë Plani Akcional dhe me ate veprohet. Dhe, a ka Komuna P/Regullativ dhe, nëse jo, ne nuk mund të vazhdojmë me procesin i cili kërkohet.

z.Arlind Rifaj- Ju drejtohem në emër të Kërkësës që i kemi bërë Kuvendit dhe do të koncentrohem në nevojën për hapësirë banuese në Komunën e Dragashit e nuk do të flas në aspektin teknik të Projektit. Ndërtesat ekzistuese në Dragash nuk i plotësojnë standardet për jetë normale në shekullin e 21-të dhe dihet se asnjë ndërtesë në Dragash nuk ka lift e sa i përket Planit Regullativ në Dragash e po të kishte atë Plan Dragashi, nuk do të kishte nevojë që të lajmërohemi këtu, ne si investues, për Pëlqim apo Leje. Në komunat që nuk posedojnë plane urbanistike, investuesit veprojnë në të njëjtën mënyrë, siç po veprojm ne sot. Komuna e Prishtinës është kryeqyteti i Republikës së Kosovës e ata kanë PUrbanistik e ne, për dallim nga ajo, nuk kemi pasur Plan të tillë për shkak të konfiguracionit. Dëshiroj të them se do të respektohen të gjitha procedurat ligjore, që të jetë në harmoni me ligjstacionin në fuqi. Po ashtu, dëshiroj të theksoj se përmes këtij Projekti, që ne dëshirojmë të realizojmë, se do të zvogëlohet papunësia në Komunë dhe, në kuadër të ligjeve, dhe, nëse keni paqartësi apo pyetje, t'i parashtroni.

z.Nexhat Isufi- Sa i përket kësaj Kërkesë, unë do të ftoj zyrtarët nga Komuna për interpretim ligjor, pasi se ka nevojë për sqarime, që të dijmë se çka dhe të jemi të gatshëm për të vendur për këtë rast. Me sa e di unë, kjo po na mungon dhe nuk kemi pasur raste të këtillë dhe është hera e parë që dikush, me letra, po na kërkon Plan Regullativ e parashtrohet pyetja se kush do t'a bjer atë Plan e ne këtu duhet të japim Pëlqim me Vendim për dhënien e Lejes së Ndërtimit. Kuvendi Komunal nuk e bënë mbikqyrjen e P/Regullativ apo Urbanistik dhe ajo, që është me rëndësi, është që mos të ngutemi e të miratojmë vendime të padefinuara e që pastaj vendimet të na rikthehen për rishqyrtim të tyre për shkak të ligjshmërisë. Ne jemi të gjithë "për" që të kemi investues, por sa i përket kësaj Kërkesë, unë personalisht, kam dyshime pasi se nuk e dijmë se si të veprohet me këtë rast, se çka ne të miratojmë dhe kujt t'i kërkojmë që të harton P/Urbanistik?! Unë, vërtetë, jam i mangët me

informata të tilla dhe në bazë të përvojës së hidhur dhe miratimit të vendimeve për të favorizuar dike, unë do theksoja që zyrtari ligjor i Komunës, që është i paguar për këtë, të na sqaron disa gjëra në bashkëpunim me DUrbanizmit e jo që ne të miratojmë vendime siç dëshirojmë, por të atilla me të cilat do të veprojmë.

z.Vehbi Nazifi- Siç po e shihni i kemi 2 kërkesa të ndryshme por identike për veprim. Në radhë të parë dëshiroj të përgëzoj investuesin që e kenë zgjedh këtë vend për investime e sidomos me projekte të ndërtimitarisë së lartë dhe, pa dyshim, se i përkrah. Vërtetë, duhet të vëhemi në pozitë të tyre se këta janë investues e ne, si Komunë, nuk kemi P/Regulativ e njerëzit kanë mjete që po dëshirojnë t'i investojnë e mos të jemi pengesë e investimeve. Unë mendoj se Kërkesa e parë është shumë e mirë, por që është dashur të sillët përmes DUrbanizmit e në këtë mënyrë do të eliminonim dilemat ligjore. Prandaj, jam i mendimit se ne duhet të japim Pëlqimin- DUrbanizmit dhe shërbimeve të tyre të posaçme që ata të kenë të drejtën e veprimit ekskluziv për çështje të këtilla e gjithçka të jetë në harmoni me rregullat ligjore. Sa më përket mua, unë mendoj se duhet përkrahur këtë Kërkesë, kurse se a do të ketë probleme nëpër ministri, kjo është çështje tjetër? Me këtë, njëherësh, duhet të përkrahët edhe DUrbanizmit që të starton me hartimin e P/Regulativ e Urbanistik të Komunës së Dragashit. Është lehtë të ndryshohet destinacioni i tokës, nëse nuk shkohet në dëm të ambientit e për këtë ekzistojnë rregulla ligjore e që pra, ne si Kuvend, mund të japim Pëlqimin e ata duhet të vazhdojnë, proceset përmes DUrbanizmit,

z.Samidin Xheladini- Kërkesa e këtill dhe të ngjajshme na shtyjnë që të mendojmë seriozisht për një Plan Zhvillimor dhe Regulativ të Komunës sonë. Pasi se ne jemi komuna më e varfër në Kosovë dhe ballafaqohemi me probleme të ndryshme zingjire, siç janë Plani Strategjik-Urbanistik, duhet të mendojmë seriozisht për këto plane, pasi se ata do të paraqitnin bazën për zhvillimin e Komunës sonë. Ne, si GP (LDK), do të përkrahim kërkesat e këtilla me arsyetim se ata do t'u ndihëmonin qytetarëve në aspektin e banimit, por që me vendime të tilla mos të vijnë në kundërshtim me ligjet në fuqi. DUrbanizmit duhet të na njofton me procedurat e që puna t'u shkon më mirë edhe palëve, nga se ata e dijnë më s miri e ne tani nuk do të dyshonim në këtë se të jepet apo jo Pëlqimi investuesëve. Megjithkëtë, ne e kemi në mendje që të përkrahën këto kërkesa.

Kryesuesi- Kalojmë në votim dhe kush është "për"-23, 0 "kundër" dhe 0 "abstenime", që pra miratohet Vendimi për dhënie e Pëlqimit të tillë në këtë Kërkesë.

Pika e VI-të (gjashtë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Vazhdojmë me punën dhe lidhur me këtë pikë – Kërkesë të NPN "Niki GD" nga Dragashi për realizimin e projekteve të parapara investuese në Dragash, fillimisht, e ftoj përfaqësuesin-en e saj të merr fjalën, urdhëroni...

z.Nazmije Tora (Niki-GD)- Do të jap arsyetim të shkurtër lidhur me Projektin. Ne jemi tim i cili ka hartuar projektin për investuesin "Niki-GD", në bazë të regjistrimeve dhe analizave që i kemi bërë,

kemi konstatuar se është i nevojshëm një investim i këtill. Ne, në radhë të parë, jemi bazuar në 2 ligje të cilët mundësojnë zhvillim ekonomik dhe investime. Këtu e kemi fjalën për Ligjin për Planifikim Hapësinor i vitit 2013 dhe Ligjin mbi Ndërtimin të vitit 2012. Kështu, në bazë të Ligjit për Planifikim Hapësinor të vitit 2013, secila komunë duhet të ketë hartat zonale e të bënë plane regulative. Po ashtu, Ligji mbi Ndërtimin flet se hartat zonale nuk mund të bëhen nga ana e të gjitha komunave në të njëjtën kohë dhe, në mungesë të tyre, investuesi është i obliguar të bënë propozim të zgjidhjes dhe këtë t'ia ofroj DUrbanizmit që t'a miraton ate apo jo të investuesit. Në Kërkesën e investuesit është edhe dokumentacioni përcjellës, siç e kërkon UA për këto procedura. Sa u përket punëve në terren, mund të them se në bazë të Kërkesës së investuesit ne kemi punuar në Projektin për zgjidhje ndërtimore, pasi se i nevojitet Komunës. Sa i përket investuesit, lokacioni është privat dhe nga materiali keni mundur të shihëni se është shansa e parë e cila i ofrohet Dragashit që të ketë një zonë urbane e mundëshme për destinacione të ndryshme e kjo do të thotë se mund të janë ndërtesa hoteliere, ndërtesa banimi, ofrimi i shërbimeve të ndryshme, hapja e bizneseve të reja etj. e që në këtë mënyrë do të ndikohej në zhvillim ekonomik të Komunës, pasi se për secilën veprimtari do të paguhen kompenzime dhe tatime ndaj shtetit.

z.Laurat Krasniqi- E para është se Komuna, për të parën herë, po ballafaqohet me rest të këtill e që raste të ngjajshme mund të na paraqiten në të ardhmen. Lidhur me këtë, më vonë do të pasojnë kërkesat tjera e që ne prap do të ndeshemi me këtë rast. Komuna e Dragashit nuk ka Rregullore në bazë të së cilës në bazë të të cilit kryetari i komunës do të vepronte për Leje Ndërtimi, liçencim etj. Pasi se nuk ka Rregullore të tillë, ne, në radhë të parë, duhet të punojmë në hartimin e Rregullores së tillë e pastaj të jepen pëlqime. Në pyetje janë ndërtime të larta dhe si kryetari do të jepte pëlqime për këto investime? Unë nuk jam kundër investimeve në Dragash, por Komuna duhet të bartë përgjegjësinë, ne si të zgjedhur të popullit duhet të konsultohemi me ekspert të fushës se nuk jemi ne ata që e njohim këtë problematikë, në mënyrë që mos të bënim gabime. Ajo që dua të them, ky rast do të na përcjell dhe se mendoj se kryetari është në një situatë se nuk e dinë çka të bënë? Për këtë nuk kemi informata nga DUrbanizmit, zyrtarët po ashtu, se a ka shkelje ligjore me këtë rast e ne mos të vendosim "blanko" e të bëjmë gabime? Unë mendoj se investuesi tash më ka filluar punimet dhe dikush ia paska ndalur apo pezulluar e tani, për arsyetim, po e kërkon Pëlqimin e Kuvendit. Mua më vjen mirë që njerëzit janë të gatshëm për investime këtu te ne dhe se e di se me situata të ngjajshme janë ballafaquer edhe delegatët e Kuvendit të Prishtinës, ku ka pasuar raste të dhënies së pëlqimeve të këtilla dhe se e di se me çfar probleme janë ballafaquer, që pra mendoj se duhet të jemi të kujdesshëm me çështje të këtilla dhe unë nuk mund të marr përgjegjësinë e dikujt tjetër.

z.Samidin Xheladini- Përshëndetje investuesit "Niki GD" i cili e ka dërguar këtë material të gjerë në Kuvend, edhe pse nuk jemi ekspert të kësaj lëmie. Ky paraqet investim kapital i cili do të ndihëmon Komunës dhe qytetarëve. Në njëfar mënyre, Komuna nuk ka kurrfar obligime e investuesi obligime financiare që të përfundon projektin dhe, sigurisht, në atë kompleks të planifikuar do të janë investimet ku do të ketë punësime dhe vende të reja pune. Sa na përket neve, na mungon P/Urbanistik

dhe përfaqësuesi i Kompanisë, mjaft mirë, na spjegoi mungesën e tij që është i nevojshëm për investime të këtilla e fjala është për procedura. Nga ne, si Kuvend, kërkohet vetëm një Pëlqim e punët tjera do t'i zbaton investuesi dhe mendoj se Ministria përkatëse nuk duhet të na hedh posht Vendimin tonë, pasi se në pyetje është vetëm Pëlqimi e jo leje e çështje tjera që i nevoiten investuesit e që do t'i kërkon nga institucionet përkatëse dhe GP (LDK) do të përkrah këtë Kërkesë dhe i dëshirojmë suksese investuesit.

z.Vehbi Nazifi- Siç po shifet kemi dy kërkesa dhe ne GP (PDK) i përkrahim kërkesat e këtilla dhe propozimet e investuesëve, në mënyrë që t'u lehtësohet puna në realizimin investimeve.

z.Nexhat Isufi- Ne jemi për realizim të këtij investimi dhe kush mendon se nuk duhet të rregullohet qyteti ynë, ai gabon. Unë dëshiroj të parashtoj një pyetje-kolegëve? Në Kërkesë theksohet kërkoj nga Kuvendi Komunal-Dragash miratimin e kushteve.., që duhet të dihet se ne nuk e bëjmë planifikimin urban, ne mund të miratojmë ndonjë Vendim për parcelë publike e këtu është fjala për objekt për qytetarë në të cilin investuesi do të fut investime e veta e pastaj ato do t'i kërkojnë. Kjo është për të mirën e qytetarëve, por pse nuk vjen DDUrbanizmit që të na sqaron disa gjëra, apo juristi-zyrtari i Komunës e mos të paraqitemi këtu, si të mirë apo të këqinjë?! Pra, kërkoj sqarime se çka nëse gabojmë e investuesin t'a fusim në probleme edhe më të mëdha dhe le të jetë përgjegjës ai i cili është kompetent? Këto dy kërkesa janë dëshmi se njerëzit po dojnë të investojnë dhe mua si qytetarë nuk më pengon se a do të ndërtojnë ata shtëpi apo pallatin prej 20 kateve e madje do të mburerm se po jetoj në qytet të tillë me ndërtesa. Ne të gjithë këtu jemi për investime, por për shkak të gjërave të paqarta dhe mungesës së Rregullores së nevojshme, për këto gjëra po vijmë në situata se si të veprohe? Se çka po votojmë, konkretisht, a mund të ma sqaron dikush, dhe se a jami ne që japim pëlqime apo vendime? Ne kemi pasur raste kur kemi votuar e vendimet na janë këthyer dhe kur e pranova materialin thash se jam për investime, por kur u thellova në te parashtrova pyetjen dhe thash se kush jam unë që jap pëlqime për këto investime?!

z.Velid Haxhisin- Paramendoj se ky material i ka kaluar procedurat para kësaj seance dhe se shërbimet juridike i kanë pasuar parasysh dokumentacionet? Por, ata nuk na kanë ofruar kurrfar rekomandime e tani mund të thuhet se shkatja është shenjë e lejimit. Unë, personalisht, pasi se e kam shikuar materialin nuk kam hasur në asgjë që na pengon që të mos japim Pëlqim për projekte të këtilla, por parashtrohet ajo se sa jam unë profesionist për këtë? Sidoqoft, unë jam "për" dhe subjekti im politik – "Vakat-i". Nëse, eventualisht, do të ketë vërejtje nga ministrinë, atëherë, bashkarisht, do t'a zgjidhim problemin.

z.Selman Osmani- Përshëndes investuesit që kanë vendosur të investojnë këtu në Dragash e kjo është sfidë dhe potez i mirë dhe ju përgëzoj dhe uroj dhe në emër të grupit tim (JGP-së) përkrahi investimet e këtilla.

z.Zaim Hajredini- Edhe unë, si parafollsit, jam për këto investime dhe e falendoj investuesin. Por, dëshiroj të theksoj se ardhmëria e këtyre investimeve varet nga vendimet e miratuara dhe për këto çështje kërkoj çasje serioze nga organet kompetente, që mos të vijmë në situata që këtu të bëhemi të mirë e kompanitë t'i sjellim para aktit të kryer, që investuesi të hargjon mjaft mjete e në fund që kjo më tutje nuk varet nga ne. Megjithatë, unë i përkrahi investimet me shpresë për investime të reja.

z.Rexhep Kamberi- Edhe ne GIG-u e përkrahim këtë Propozim dhe u gëzohemi investimeve në Dragash, pasi se do të shtonin investimet përmes shtimit të punësimit dhe pajtohemi me parafollësit për hartimin e Planit Urbanistik apo Regullativ, që raste të këtyra mos të na ngjajnë në të ardhmen. Po ashtu, dëshiroj të tërheq vëmendjen që, për raste të këtyra, DUrbanizmit apo zyrtar tjetër kompetent të na sqaron neve delegatëve gjendjen për të vendosur për këto raste. Këtë e theksoj nga se është i nevojshëm hartimi i PU, pasi se mungesa e tij po i pengon investuesit në Komunën tonë. E dyta, ne jemi në shekullin e 21 e kemi situatën kur, në pjesën e poshtme të Dragashit, nja 30 shtëpi nuk e kanë rrugën e tyre e që duhet ofruar zgjidhje për të ngel peng i tekeve të 2-3 personave?

Kryesuesi- Pasi se nuk kemi diskutime tjera, kush është për miratimin e kësaj Kërkesë...? 24 "pro", 0 "kundër" dhe 0 vota "të përmbajtura, që konstatoj se miratuar është Kërkesë dhe pikë të rendit të ditës.

Pika e VII (shtatë) e rendit të ditës -"eventuale"...

Vazhdojmë me punën, urdhëroni, paraqituni në kadër të pikës së VI-të dhe të fundit – "eventuale"...

z.Naser Myrtezani- "S' pari kisha kërkuar përgjigjet në pyetjet nga seanca e kaluar. E para ka të bëjë me investimet në fushën e arsimit. Tash është periudhë e investimeve në kuadër të Komunës e çështja ka të bëjë me shkollën e Zaplluxhes e cila është ndërtuar nga qeverisja e LDK-së, por në këtë shkollë, për 10 vite nga qeverisja juaj, thuaj se nuk është investuar asgjë, përveç të disa pllëmbë kubëzave në oborr, një mini-rrethoj e lënë në gjysmë e një objekt i vogël për dru. Ju kryetar dhe ju drejtor i Arsimit duhet të dini se shkolla e Zaplluxhes është e vetmja në komunë e cila e ka rrugën e pa kubëzuar, shkolla ka nevojë për rinovim të brendshëm, paisje me kompjuterë, izolim të jashtëm, nxemje qendrore, të kryhen rrethojat, të ndërtohet një mini-stadium për nxënësit dhe, që është më e keqja, që për 2 vite, shkolla nuk ka fare toaleta. Pra, kërkoj z.kryetar që të keni parasysh shkollën e Zaplluxhes? E dyta, ka të bëjë me arsimin e unë si delegat, qytetar e profesor i shkollës së Bresanës

kërkoj që të gjenden mjete për transportin e nxënësëve të fshatit Buzez, nga ata parafillor e deri në klasën e V-të. Kjo është kërkesë edhe e banorëve të Buzezit, për shkak se fëmijët e tyre janë të rrezikuar nga automjetet dhe kafshët. Kërkoj që të sigurohet transport nga qenda e fshatit e deri te shkolla e anasjelltas. Unë shohë, çdo ditë, kur brenda në vetura private futin shumë fëmij për t'i dërguar në shkollë e anasjelltas dhe, sikur të ndodhë ndonjë fatkeqësi, e di se fajin do t'a marrë shoferi i veturës, por faji nuk do të ngelë vetëm te ai por edhe te ju dhe drejtori i DKA-së? Pra, nuk po kërkoj për fëmijët e nga klasa e VI-IX, por për fëmijët deri në klasën e V-të. E treta, një shqetësim tjetër ka të bëjë prap me arsimin, pasi se tash është fundi i vitit shkollor dhe, çdo vit, organizohet testi i semi-maturës dhe i maturës shtetërore, Unë punoj që 14 vite në arsim dhe, deri më tani, edhe këtu kam vërejtur probleme e pa kënaqësi. Shtrohet pyetja se çfarë ka ndodhur këtu? Për këto vite, sa unë punoj, kam vërejtur, edhe në shkollën time dhe në të gjitha shkollat e Komunës sonë, se profesorët që shkojnë si monitorues të testit të maturës, përzgjedhen thuhet se të njejtë dhe, kryesisht, ata që përkrahin pushtetin, që i bie votuesit tuaj, kurse ne të tjerët, kur, nuk kemi qenë të caktuar për diçka të tillë?! Dhe, për t'u çuditur është se kemi punëtorë që punojnë nga 30-40 vite dhe kurrë nuk kanë qenë monitorues, kurse kemi të tjerë, me nga një-dy vit përvojë, e i dërgoni atje, vetëm e vetëm, që të marrin nga një mëditje dhe, kur janë pyetur organet kompetente, ja kanë hedhur fajin, njëra-tjetrës, për emrat e profesorëve?! Andaj, kërkoj nga drejtori i DKA-së që të ndalet kjo paraktikë, për shkak se politika nuk duhet të përzihet edhe nëpër shkollë, siç kemi rastin deri më tani. Në fund, kisha kërkuar që të më përgjigjeni në pyetjet e seancës së kaluar, pra: 1. Çështja e punësimeve politike në arsim, 2. Çështja e kanalizimit në Zaplluxhe, 3. Çështja e zyrës së KEDS-it në Bresanë dhe 4. Çështja e pensionistëve të arsimit?"

Kryetari- Menjëherë po filloj me pyetjen që parashtrou z.Naser M., duke me vazhduar me ato të seancës së mëparshme. Sa i përket shkollës në zaplluxhe, vërtetë, nuk kemi arritur t'i kryejnë disa investime në atë shkollë. Por, menedoj se vetë shkolla dhe qytetarët duhet të llobojnë pak më shumë që të tërheqin investime në fshat dhe shkollë. Realisht, nuk është shkuar deri në fund me këto investime, zhvillohen punët rreth rrugëve e janë të parapara 100 mijë euro për këtë shkollë për perishën vijuese. Sa i përket transportit të nxënësëve të f.Xerrxe, kjo është çështje shqetësuese, sidomos për ata të klasëve të ulëta dhe jemi në dijeni për hapat që duhet ndërmarrë. Me këtë është duke u marrë direkt DKA-ja, për ofrim të zgjidhjes. Sa u përket provimeve të maturës dhe mësimdhënësit e angazhuar, unë nuk e di se ka qenë ashtu siç theksohet, por duhet ditur se me këtë çështje, drejtpërdrejtë, merret DKA-ja e unë nuk jam në dijeni për konstatimet e bëra nga parafolësi N.M. Por, unë, gjithësesi do të bisedoj me drejtorin e DKA-së rreth këtyre konstatimeve. Sa i përket pyetjes rreth stadiumit të qytetit, po theksoj se atje janë zhvilluar disa punime e që nuk janë kryer si duhet e që sot nuk po mujm të organizojmë gara nga arsyeja se punët nuk janë kryer si duhet. Ndërkaq, sa i përket asaj se është mirë të ndërtohet stadium edhe në "Mejdan të Buzezit", po theksoj se, momentalisht, jemi në kontest pronësor me AKP-në rreth pronësisë e që nuk mund të ndërmarrim asgjë deri në Aktvendimin e gjykatës. Madje, nga ministritë kemi shkresë se, edhe komuna, më nuk do të ketë të drejtën e dhënies së pronës në shfrytëzim, apo pronësi? Por, gjithësesi, ideja nuk është e

keqe që të kemi edhe një stadium atje e që duhet pasur në konsideratë me rastin e orjentimit të donatorëve potencial. Çështje tjetër ishte dhënia e 3 pagave jubila mësimdhënësëve që shkojnë në pension e këtë duhet bërë nga se kanë garantim ligjor e atë mund t'a kërkojnë përmes gjykatës e që ato paga duhet paraparë me buxhetin-sivjet. Lidhur me konkuret në shkolla, po theksoj se, fatmirësisht, kemi mjaft persona të arsimit, por, mjerisht, pak vende të punës për të gjithë të kualifikuarit. Siç dihet, kemi pasur Konkurs në arsim dhe ata që kanë konkuruar, prej të cilëve nuk kanë qenë të kënaqur dhe kanë parashtruar ankesa, por që, zyrtarisht, kemi vetëm një ankesë e cila në është në procesin e vlerësimit e që mendoj se do të përfundon në suaza të dispozitave ligjore. Me rëndësi, është se procedura e konkursit ka qenë në rregull, duke u respektuar procedurat dhe kriteret. Te çështja e zyrës së KEDS-it në Bresanë, kjo brengos, nga se ishte në të mirë të qytetarëve, por kjo është firmë private e cila i ka rregullat e veta, por tani ka mundësi që faturate energjisë të paguhen edhe përmes zyrës së Postës, që ndoshta, për këtë edhe është mbyllur. Çështja e kanalizimit në Kuk, por Zaplluxhe është problemeatike dhe kjo është kuptuar menjëherë, si pasojë e vendosjes jociësor të gypava dhe punëve joadekuate ndërtimore, që paraqet mosukses të tonin dhe të donatorit. Kishte pyetje reth vendosejs së shenjave të komunikacionit për në rrugën Restelicë e një emër që nuk, ekziston te ne, kjo është brengosëse dhe ne do të angazhohemi me Inspektionin që kjo gjendje të verifikohet? Njëra nga pyetjet ishte edhe dhënia e kamerës RTK-së për nevojat e komunitetit jo shumicë, për të përfshi informata nga komuna jonë e që kjo ngjanë. Por, nëse vërehet se ka keqpërdorim të saj, siç u theksua, mund të vendosen kontakte me kompetentët e RTK-së se si qëndron çështja? Sa u përket subvencioneve, ato, deri tash, janë shfrytëzuar në tërësi dhe se to mund të shikohen në çdo moment nga të interesuarit. Lidhur me ekzistimin e rrugëve në rrugë rajonale, kjo është kompetencë e MInfrastrukturës e që, fatmirësisht, jeni dëshmitar se po sanohen. Pyetjes reth vendimeve të kryetarit, po theksoj se ato janë transparaente në web-faqen e Komunës e është çështje teknike nëse ndonëra nga ato mungon? Në pyetjen lidhur me zgjedhjen e nënkryetarit të Komunës, për komunitete, është fakt se e kemi shkresën e MAPL-së dhe se ajo e ka paditur Komunën e që ne jemi në pritje të Vendimit gjyqësor për të vepruas sipas tij se a do të vazhdon apo jo mandatin dhe funksionin ku procedura ka qenë në rregull. Në lidhje me pyetjen e z.Rexhep K. reth qenëve endacak , ajo ndërlidhet me atë të z.Zinaida E. lidhur me sulmin e qenëve të familjes së blëegtorit nga Brodi ndaj qytetarëve të Dikancës-Mlikut, që jemi angazhuar që për këtë të intervenojnë edhe inspektorët komunal, përmes vizitës e bisedës me atë fermer, kurse jam në dijeni se rasti i tillë qenka përcjell edhe në Gjykatë.

z.Shpetim Hajredini- Në fjalim tim të mëparshëm mendoj se u keqkuptova dhe kërkoj sqarime. Unë, në fjalimin tim, nuk kam kërkuar që ndërmerret diçka jo ligjore e antikushetuese. Unë dëshiroja e që edhe theksova që Komuna, përkatësisht DKRSportit, të organizon manifestime sportive me rastin e Ramazan-Bajramit, pasi se, me sa më kujtohet, më herët, janë organizuar turnet e tilla te "Tregu i Gjelbërt" në Bresanë. Mendoj se ky është vetëm sqarim, si dhe e falënderoj kryetarin që ato çështje që parashtrua në seancën e kaluar, i ka realizuar.

z. Sevim Avdullahu- E kam një kërkesë e cila më është përcjellur nga qytetarët e që kërkon përkrahjen e delegatëve. Qytetarët që na e kanë besuar votën kërkojnë nga ne përgjegjësi, duke u themeluar një Komision, të përbërë edhe nga subjektet politike, për të mbikçyruar punimet e punëkryesëve në lokalitetet e Komunës sonë. Kjo kërkesë e qytetarëve bazohet në 3 arsye. E para është transparenca e parasë publike, e dyta moskryerja si duhet e punimeve e sipas kontratave të nënshkruara me Komunën dhe treta, mosbesimi i qytetarëve në organet kompetente të themeluara nga Komuna apo Zyrja e Kryetarit e këtë e kërkoj në emër të qytetarëve, zë i të cilëve jemi ne?

z. Rexhep Kamberi- Unë do të ndërlidhem në diskutimin tim të mëparshëm dhe i parashtroj pyetje kryetarit se kur do të hartohet PUrbanistik i Komunës dhe se e a po punohet në te, pasi se është i rëndësishëm vitale për Komunën, pasi se ka probleme si psh. në rastin e zjarreve dhe smundjeve e që për disa familje mungon kyçja deri te ato në pjesën e poshtme të Dragashit, duke qenë peng e 2 familjeve të cilat nuk lejojnë hapjen e rrugës e që duhet të bisedohet nga kompetentët e Komunës?

z. Nexhat Isufi- Kam një kërkesë të një punëtori të arsimit i cili thot se , një kohë të gjatë, kërkon transfer dhe se ka bërë kërkesën në DKA e cila është pranuar dhe protokoluar e ai person ka filluar të punon, por që drejtori i DKA-së i paska dhën përgjigje se nuk lëshon vendime për ndërrim dhe transfer të vendit të punës? Po ashtu, thekson se drejtori i DKA-së i paska thënë se nuk do të merr Kontratë se nuk qenka anëtar i partisë së tij?! Prandaj, ky punëtor më është ankuar mua se rasti do të përcillet deri në Ministri. Unë i sugjerova mos të ngutet, pasi se e kemi Komunën, përmes së cilës mund të zgjidhet problemi dhe kërkoj që të gjendet zgjidhja, nëse ka mundësi në kuadër të bazës ligjore?

z. Samidin Xheladini- Ka dy kërkesa për kryetarin e Komunës. E para, të na thuhet se deri ku është arritur me ndërtimin e urës në Bresanë dhe e dyta, të njoftohemi lidhur me vizitën që e ka bërë në Komunën tonë z. Natalija Aopostolova? Po ashtu, kam edhe një kërkesë të qytetarëve për hapjen e trases së rrugës Bresan-Brrut, përmes fushës? Gjithashtu, që një kohë të gjatë, punëtorët dhe ne nuk po i nënshkruajmë listat e pagave e që, mua personalisht nuk po më pengon, edhe pse, për shkak të transparencës, e kam kërkuar që 10 vitet e fundit? Kam edhe një kërkesë-ankesë të banorit të Restelicës të cilit te fshati Brezne i paskan pëlçitur gomat e veturës, për shkak të gropave në atë rrugë? Ndërkaq, sa i përket punësimit, po ja përciell kryetarit se në konkurset e fundit janë pranuar punëtorë që kanë qenë strikt nga partia juaj-PDK-ja?!

z. Zinaida Elmazi- Në PN "Sharri" punësohen 3 punëtorë nga komuniteti shumicë e që mendoj se duhet pasur parasysh këtë, pasi se kam dësgjuar se duhet të punësohen 12 veta e të merret parasysh barazi nacionale e rajonale? Në seancën e klauar parashtrova një pyetje në të cilën nuk më dha përgjigj kryetari lidhur me zjarrin që ngjau para një viti në Shtëpinë e Kulturës në Dragash, se a ka informata zyrtare dhe se a është zgjidhur kjo çështje, a ka propozime për shpenzimet e bëra ndaj institucioneve, për të cilat janë të interesuar qytetarët dhe unë personalisht, pasi se aty ka qenë e vendosur "Radio-Gora", Qendra Rinore etj. dhe se a janë bërë kërkesa për kompenzim eventual të dëmeve të shkaktuara nga zjarri. Herën e fundit u fol reth kamerës së dhënë nga Komuna për RTK-në

e është jologjike të jepet kamera e tillë, por edhe nëse jepet të dihet me cilat kushte? Pasi se RTK-ja e ka buxhetin prej 11 milionë eurove, s'ka kuptim dhe logjikë që ne, si komunë më e varfër në Kosovë, të dhurojmë për një institucion të madh e që nuk respektohen ngjarjet, siç duhet në Komunë e as ne si delegat të saj, që pra dëshiroj të kemi Kontratën se sipas të cilave kushte qenka dhënë ajo kamerë nga Komuna jonë?!

z.Zaim Hajredini- Pasi se jemi te kjo pikë "eventuale", do t'a kisha pyetur kryetarin se a ka mundësi të shpejtohen punët në asfaltimin e rrugës për në "Liqenin e Breznes", pasi se jemi në sezonin turistik e që aty ofrohen atraksione turistike e që është si nevojë dhe strategji atraktive turistike e paraparë edhe me planet tona strategjike?

Kryetari- Lidhur me atë që theksoi z.Shpetim H. reth organizimi të manifestimeve sportiv edhe gjatë festave fetare, po thesoj se nuk ka penegesa ligjore e ajo që mund të bëhet edhe gjat muajit të shenjt të Ramazanit e imja mund të jetë që t'i ftojë imamët e KBIslame në iftar të përbashkët, e nëse diçka çmohet si aktivitet fetar të bëhet në bashkëpunim me KBIslame si komptente për këto çështje. Ndërkaq,parafolësit (Sevim A.) që kërkoi themelimin komisionit për mbikçyrje të punimeve investuese, them se ai mund të themelohet kur të dëshironi, pasi këtë e keni të drejtë Ju - si Kuvend, që të themeloni "ad hock" komisione për secilin projekt që dëshironi. Dhe, pavarësisht se a është fjala për projekte, arsim, shëndetësi etj.Kuvendi ka të drejtën e themelimit të komisioneve dhe unë do të mburresha me komisione të tilla e ne, si pushtet ekzekutiv, do të ofronim përkrahje në formë të transportit dhe përkrahjes teknike. Sa i përket Purbanistik, deri sa unë isha delegat-në mandatet e kaluara, mendoj se kemi pas ndarë 40 mijë euro për hartimin e hartave zonale dhe, nëse e bëjmë revidimin e buxhetit, nuk do të ishte keq që mjetet të parashihen për hartimin e P/Urbanistik, si dhe obligimi që të kemi P/Hapësinor. Sa i përket rrugës në pjesën e poshtme të Dragashit, mendoj se atje është në pyetje inati në mes të komshive dhe, unë personalisht, isha i angazhuar që ai kontest të zgjidhet, por, për momentin, kjo ishte e pamundur. Është logjike që njerëzit atje të kanë rrugë, për të depërtuar automjetet e zakonshme, ambulancat etj. Për këtë kemi pasur edhe Peticion të qytetarëve e që ende nuk është gjetur zgjidhje. Z.Nexhast I. e përmendi një transfer të punëtorot të arsimit, për këtë ekzistojnë procedura që duhet respektuar e përfillur dhe, nëse DDKA paska deklaruar ashtu, siç deklaruat këtu, ndaj atij punëtori, kjo nuk është aspak e mirë. Për këtë, unë do të bisedoj me DDKA-së se si ka qenë rasti, pasi se ajo çka u theksua nuk është termi me të cilin duhet të shprehet një Drejtor si ai i DKA-së. Z.Samidin parashtroi pyetjen e rikonstrumit të urës në Bresanë e unë po theksoj se jemi në rikontruim të saj dhe besoj se punët do të kryhen shpejt, përfshi edhe premtimet e MInfrastrukturës për dy projekte. Njëri nga projektet është ndërtimi i shtratit të lumit dhe mureve mbrojtëse e që kushtojnë. Sa i përket trases së rrugës Bresanë-Brrut mendoj se kjo ende nuk është prioritet, kurse sa i përket vizitës së z.Natalija Apostolova, me sa jem në dijeni, ka pasur takime edhe me delegat të grupeve parlamentare. Ai ishte një takim joformal, meq rast z.Apostolova, e shoqëruar me një grup ambasadorës në Kosovë, ka vizituar qytetarë të Restelicës dhe e ne e kemi shfrytëzuar rastin që, sado-kudo, të afrohem i dhe paraqesim të arriturat dhe nevojat tona. Po theksoj, se është

mirë që njerëz të till të arrijnë te ne që të janë prezente në forma të ndryshme shtet e tyre, në kuptim të realizimit të projekteve, siç ka qenë projekti i rrugës Krushevë-Shishtavec. Sa i përket punësimit në PN "Sharri", unë, vërtetë, nuk jam në dijeni, se a ka pasur Konkurs, nga se ai është institucion i ndarë nga ne. Mendoj se ata vetë do të publikojnë Konkurs dhe do të zhvillojnë procedurat e nevojshme, përfshi edhe njohurit të kanë për konfiguracionin e terrenit dhe, me siguri, do të angazhojnë punëtorë nga këto anë. Sa i përket zjarrit në Shtëpinë e Kulturës në Dragash, ajo që e dijë unë është Raporti i vitit të kaluar dhe, nga atëherë, s'kemi asgjë të re lidhur me rastin, dëmet janë të mëdha, kurse, me gjasë, shkaktare është instalimet e rrymës elektrike. Ndërkaq, sa i përket asaj kamere të RTK-së në Zyrën e Prokurimit, duhet të jetë Kontrata se nën cilat kushte është ndar ajo dhe ndarja e saj është për çështje afirmative për komunitetin e Gorës. Asfaltimi i rrugës kah "Liqeni i Breznes", po theksoj se MInfrastrukturës e ka hequr nga asfaltimi dhe ne, me Ministrin Pal Lekaj, kemi kërkuar të na përkrah dhe se ne do të participojmë, pasi se me asfaltimin e asaj rruge do të krijohet atraksion turistik deri në "Liqenin e Breznes", kurse kjo rrugë llogaritet se do të kushtonte 150 mijë euro dhe shpresojmë në përkrahejen e Ministrisë.

Kryesuesi- Nëse nuk kemi diskutime të tjera, me këtë, përfundojmë seancën e sotme të Kuvendit. Ju felemderit dhe mirë u pafshim në seancën e radhës.

E përgatiti :

Shërbimi i Kuvendit Komunal

Kryesuesi :

Betim Merdiu



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality

LISTA

E anëtarëve-delegatëve të Kuvendit Komunal Dragash
Članova-delegata Skupštine Opštine Dragaš

Nr.seancës
Br.sednice

1-10

Nr Br	Emri dhe mbiemri Ime i prezime	Subjekti politik Politički subjekat	Nënshkrimi Potpis
1	Betim Merdiu	PDK	[Signature]
2	Shpetim Hajredini	PDK	[Signature]
3	Xhemile Misinaj	PDK	[Signature]
4	Artan Loshaj	PDK	[Signature]
5	Vehbi Nazifi	PDK	[Signature]
6	Granit Rifaj	PDK	[Signature]
7	Suada Bajrami	PDK	[Signature]
8	Sevim Avdullahi	PDK	[Signature]
9	Elira Sulejmani-Krasniqi	PDK	[Signature]
10	Samidin Xheladini	LDK	[Signature]
11	Refik Latifi	LDK	[Signature]
12	Sefidin Mejzini	LDK	[Signature]
13	Naser Myrtezani	LDK	[Signature]
14	Arijeta Skeraj	LDK	[Signature]
15	Aida Misini-Halimi	LDK	[Signature]
16	Adelisa Krasniqi	LDK	[Signature]
17	Veljod Hadžisin	Vakat	[Signature]
18	Munir Jonuzi	Vakat	[Signature]
19	Zinaida Elmazi	Vakat	[Signature]
20	Seljman Osmani	JGP	[Signature]
21	Hatidža Šeh	JGP	[Signature]
22	Laurat Krasniqi	LVetëvendosje	[Signature]
23	Hajrudin Hodža	PGora	[Signature]
24	Nexhat Isufi	Nisma	[Signature]
25	Zaim Hajredini	AKR	[Signature]
26	Florent Rufati	AAK	[Signature]
27	Redžep Kamberi	GIG	[Signature]

Dragash dt. 15.05.2018

Kryesuesi - Presedavajuci